



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Nr ____ Prot

Datë 15/10 / 2009

V E N D I M

Nr. 127 Datë 15.10 .2009

“Mbi

autorizimin e përqendrimit për përfitim kontrolli në shoqërinë BP Greece Limited, nga shoqëria Hellenic Petroleum SA nëpërmjet blerjes 100% të veprimtarisë ekonomike të tregtimit të shoqërisë BP Hellas SA”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e :

- | | |
|----------------------------|---------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| ▪ Zt. Koço Broka | Anëtar |
| ▪ Znj. Rezana Konomi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 15.10.2009, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit për përfitim e kontrollit në shoqërisë BP Greece Limited, nga shoqëria Hellenic Petroleum SA nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë target BP Hellas SA..

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, shkronja d, neni 2, nenet 10-12, Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53-56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Aneksi I - Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm bashkëlidhur këtij raporti

V Ë R E N S E:

Palët:

Shoqëria Hellenic Petroleum International AG, në cilësinë e blerësit, filiale e zotëruar 100% nga shoqëria Hellenic Petroleum,

Shoqëria Hellenic Petroleum, me seli në Greqi, është shoqëria mëmë e grupit Hellenic Petroleum SA, një kompani hidrokarburesh e integruar vertikalisht, që nëpërmjet filialeve të saj ushtron veprimtari brenda dhe jashtë Greqisë për prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e karburanteve dhe nënprodukteve të tij, në fushën e kërkimit të burimeve të naftës dhe gazit; në fushën e prodhimit të kimikateve me bazë hidrokarburesh, si dhe është aktive në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike.

BP Greece Limited, në cilësinë e shitësit, me seli në Britaninë e Madhe, është pjesë e grupit BP International, që ushtron veprimtari në tregun e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të karburanteve. BP Greece Limited është zotëruesi 100% i shoqërive bija që ushtrojnë veprimtarinë në tregun me shumicë dhe pakicë të depozitimit dhe tregtimit të karburanteve në Greqi: BP Oil Hellenic SA dhe BP Hellas SA Oil Trading.

Shoqëria BP Hellas SA Oil Trading, objektivi i operacionit (target), me seli në Greqi, ushtron veprimtarinë e saj të depozitimit dhe tregtimit në të dy nivelet e tregut (me shumicë dhe pakicë), për produktet e përpunuara në Greqi të karburanteve.

Përqendrimi

Transaksioni i njoftuar konsiston në blerjen e veprimtarisë ekonomike (biznesit) të BP Hellas SA Oil Trading pas ristrukturimit të saj që realizohet brenda grupit BP. Veprimtaria ekonomike e BP Hellas pas ristrukturimit përfshin veprimtarinë e depozitimit dhe furnizimit industrial në tregun me shumicë (depozitat me kapacitet 170.000 m³, si dhe 1200 stacione shërbimi në tregun me pakicë, brenda territorit të Greqisë.

Në Shqipëri, Helpe është e pranishme në nivelin e shumicës nëpërmjet shoqërisë Global Petroleum Albania Sha, me pjesë tregu në total 10% dhe në tregun me pakicë nëpërmjet shoqërisë bijë të saj Elda Petroleum Albania Shpk, me pjesë tregu 5%.

BP Hellas SA nuk është e pranishme në tregun shqiptar.

Xhiro për vitin 2008

Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është 11,974 Milion Euro= 1472 miliardë lekë dhe përfshin xhirot (Hellenic Petroleum me 10.130.98 Milion Euro; dhe BP Hellas SA 1.664 milion Euro);

Xhiro totale **në tregun e brendshëm** është 6 miliardë lekë dhe përfshin xhiron e Global Petroleum Albania dhe Elda Petroleum Albania Shpk.

Tregu Përkatës:

Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet prodhimi, përpunimi, depozitimi, tregtimi i karburanteve për mjetet tokësore dhe vajrave lubrifikantë. Për secilin nga

këto nëndarje, tregu segmentohet më tej në dy nëndarje të mëdha: Tregu me shumicë dhe tregu me pakicë.

Theksojmë se secila nga palët pjesëmarrëse në përqendrim është e integruar vertikalisht dhe horizontalisht në treg (përfshirë këtu tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë dhe pakicë.

Tregu përkatës i produktit:

Prodhimi dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i karburanteve për mjetet tokësore (benzinë, Eurodisel/D1).

Në Shqipëri:

Helpe është e pranishme në nivelin e shumicës nëpërmjet shoqërisë Global Petroleum Albania Sha, me pjesë tregu në total 10% dhe në tregun me pakicës nëpërmjet shoqërisë bijë të saj Elda Petroleum Albania Shpk, me pjesë tregu 5%.

BP Hellas SA

nuk është e pranishme në tregun shqiptar.

Tregu përkatës gjeografik: Për vlerësimin e efekteve që do të sjellë në treg ky transaksioni, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet **tregu i brendshëm**/territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregje të prekura

Në bazë të përkufizimit të tregjeve të prekura sipas seksionit 6(III) të “Formularit të njoftimit të përqëndrimit”, nuk ka tregje të prekura nga përqëndrimi i njoftuar as horizontalisht dhe as vertikalisht, mbasi BP Greece Limited dhe bija e saj, BP Hellas nuk është e pranishme në tregun përkatës(tregun gjeografik-Republika e Shqipërisë dhe tregun e produktit-tregtimi i karburantit për mjetet tokësore).

Si konkluzion

Përqëndrimi nuk mund të ketë efekte antikonkurruese pasi nuk prek në mënyrë të drejtëpërdrejtë tregun gjeografik të Republikës së Shqipërisë, pasi ndërmarrja objekt-trasaksioni BP-Hellas ushtron veprimtarinë në tregun e tregtimit me shumicë dhe pakicë të karburantit vetëm për mjetet e transportit rrugor në Greqi ndërsa BP-Albania ushtron veprimtarinë vetëm në tregun e karburanteve për avionë në Shqipëri dhe nuk ka prezencë në tregun e karburanteve për mjetet tokësore në Shqipëri. Për këto arsye, përqëndrimi i realizuar nuk ndryshon strukturën e tregut përkatës dhe si pasojë nuk krijon apo forcon pozitën dominuese të ndërmarrjeve në tregun e karbuanteve në Republikën e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, shkronjat d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar për përfitim e kontrollit në shoqërisë BP Greece Limited, nga shoqëria Hellenic Petroleum SA nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë target BP Hellas SA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
(_____)

Anëtar

Rezana Konomi
(_____)

Anëtar

Koço Broka
(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE